

Lista përgatitore përpara nisjes

- I kam dërguar të gjitha **bagazhet e tepërta**. Sasia e bagazheve dhe numri i kilogramëve të lejuara tregohet qartë në fletën e rezervimit të fluturimit.
- Kam me vete **gesen plastike të IOM-it** dhe do ta mbaj atë në mënyrë të dukshme, nëse do të jetë e nevojshme për asistencën gjatë transitit dhe mbërritjes në aeroport.
- Kam pasaportën time origjinale dhe të vlefshme ose Dokumentin e Udhëtimit Urgjent/Leje Kalimin, si edhe ato të të gjithë personave në ngarkim.
- Nuk kam **lëngje** (përfshirë ushqime të lëngshme apo artikuj kozmetikë të lëngshëm), kremra apo produkte në trajtë veshulllore në bagazhet e dorës.
- Kam informuar Këshilltarin tim për **nevojat e veçanta** gjatë udhëtimit (ushqime, mjekime, karrocë për invalidë, sëmundje, etj.).
- Për gratë shtatzëna:** Kam marrë autorizimin me shkrim të mjekut që më lejon të udhëtoj me avion si **grua shtatzënë**, dhe ku specifikohet numri i javëve të shtatzënisë.
- Të gjitha **mjekimet dhe trajtimet** për të cilat kam nevojë gjatë udhëtimit, si dhe vërtetimin origjinal të mjekut, i kam me vete në bagazhet e dorës.
- Të gjitha mjekimet që nuk më duhen gjatë fluturimit i kam vendosur në çantat që do të transportohen si bagazhe të regjistruara.
- Të miturit e pashoqëruar:** I kam të gjitha dokumentet e nevojshme për të udhëtuar si **i mitur i pashoqëruar**, përfshirë autorizimin e prindërve dhe të kujdestarit ligjor.
Vetëm nëse keni aplikuar dhe keni të drejtë të merrni ndihmesë për ri-integrimin nga IOM:
- Kam nënshkruar Formularin e Aplikimit për Ri-integrim gjatë takimit këshillues përpara nisjes.
- Do të nënshkruaj Marrëveshjen e Ri-integrimit pak përpara nisjes në aeroport.
- Kopjen origjinale do ta mbaj me vete, edhe pas kthimit.
- Jam në dijeni se të dhënat e kontaktit të zyrës së IOM-it në vendin tim të origjinës janë dhënë në Marrëveshjen e Ri-integrimit.

Komentet nga këshilltari ose asistenti juaj social:

UDHËZUES I UDHËTIMIT PËR TË KTHYERIT

Programi i kthimit vullnetar nga Belgjika



ALBANIAN



Po ktheheni në atdheun tuaj?

Kthimi dhe Emigrimi i Azilkërkuesve nga Belgjika


Ju keni aplikuar për kthimin vullnetar nga Belgjika me ndihmesën e Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM). Ne po bëjmë çdo përpjekje për t'ju ardhur në ndihmë në çdo hap të procesit të kthimit tuaj.

Lutemi të lexoni me kujdes këtë fletëpalosje.

Kthehuni sot për të ndërtuar të nesërmen

Në aeroport (Aeroporti Kombëtar i Brukselit /Zaventem)

- Për të garantuar një udhëtim të qetë dhe për të shmangur çdo vonesë të mundshme, duhet të respektoni rreptësisht numrin e bagazheve dhe kilogramët e lejuar.
- Pika juaj e takimit është radha 6, **3 orë përpara** orarit së nisjes.
- Në radhën 6, do të takoni një nga asistentët e aeroportit të IOM-it, të cilët identifikohen lehtësisht pasi mbajnë xhaketën dhe kapelën blu të IOM-it.



- Një nga asistentët e aeroportit të IOM-it do t'ju ndihmojë me procedurat përpara hipjes në avion, përfshirë procedurën e regjistrimit të bagazheve tuaja, kontrollin e sigurisë dhe të pasaportave.
- Asistenti i aeroportit të IOM-it do t'ju shoqërojë drejt portës së hipjes, ku do t'ju japë lejen e hipjes në avion.
- Për t'u identifikuar lehtësisht nga personeli i IOM-it përgjatë gjithë udhëimit tuaj deri në aeroportin e fundit, duhet të mbani një **çantë të IOM-it**.



Në transit

- Nëse nuk keni linjë të drejtpërdrejtë fluturimi, personeli i IOM-it do t'ju ndihmojë në aeroportet kryesore të Evropës.
- Nëse është rënë dakord përpara nisjes, IOM-i do t'ju ndihmojë gjatë fazës së transitit jashtë Evropës, nëse është e mundur.
- Nëse do të ndihmoheni nga IOM-i në transit, është e detyrueshme që të mbani me vete çantën tuaj të IOM-it. Kështu, Kolegjet e IOM-it do të jenë të aftë t'ju identifikojnë më mirë.
- IOM-i garanton nisjen tuaj të sigurt dhe në kohë me fluturimin lidhës.
- Nëse keni informuar këshilltarin tuaj se keni nevojë për ndihmë mjekësore të veçantë, IOM-i do t'ju sigurojë ndjekjen e duhur me shoqërinë e udhëtimit dhe shërbimet e aeroportit.
- Nëse gjatë transitit nevojitet qëndrimi për një natë, IOM-i mund të marrë masat për akomodimin tuaj.

Në mbërritje

- Nëse bihet dakord paraprakisht, IOM-i do t'ju mirëpresë me mbërritjen tuaj në destinacion dhe siguron transportin tuaj të mëtejshëm deri në destinacionin përfundimtar në vendin e origjinës. Për t'u identifikuar më lehtë nga IOM-i, duhet të mbani me vete çantën e IOM-it.
- IOM-i do t'ju ndihmojë gjatë procedurave të nevojshme, përfshirë kontrollet doganore dhe të migracionit.
- Nëse ju nevojitet ndihmë mjekësore e veçantë, IOM-i siguron ndjekjen e duhur me shërbime në terren (për shembull, ambulancë dhe/ose mjek).



Ju urojmë kthim të sigurt në shtëpinë tuaj!

IOM Belgjikë dhe Luksemburg

Rue Montoyerstraat 40
1000 Bruksel

Telefon: +32 (0) 2 287 70 00
Faksimile: +32 (0) 2 287 70 05
Email: IOMBrusselsREAB@iom.int
Organizata Ndërkombëtare
për Migracionin

